

fakte

Dhuna seksuale

Dhuna seksuale është problem serioz i shëndetësis publike që i prek miliona njerëz çdo vitë në të gjithë botën. Ajo inicohet nga shumë faktorë të cilët funksionojnë në kontekste sociale, kulturore dhe ekonomike.

Seksi i detyrueshëm mund të rezultojë në kënaqje seksuale të kryesit, edhe pse qëllimi i tij themelor shpesh herë është shprehje e dominimit dhe fuqis mbi personin e sulmuar. Ai përdoret edhe për dënimin e njerëzve për tejkalimin e kodeksit social dhe moral.

SHKALLA E PROBLEMIT

- Nuk dihet shkalla e vërtet e dhunës seksuale edhe pse të dhënat e disponueshme sugjerojnë se një nga katër gra gjatë jetës së tyre mund të përjetojnë dhunë seksuale nga partneri i tyre intim.
- Për shumë gra të reja, dhuna seksuale fillon qysh në fëmijëri dhe në adoleshencë. Në disa vende, deri në një të tretën e vajzave adoleshente paraqesin marrëdhënie seksuale të parë të detyruar.
- Çdo vitë qindëra mijëra gra dhe vajza blihen ose shiten për prostitucim. Shumicës së tyre ju premtohen punë shtëpiake ose në veprimtarin e dhënjes së shërbimeve, por në vend të kësaj ata dërgohen nëpër shtëpija publike, ku rrihen, mbyllen dhe ju merren dokumentet për identifikim dhe i detyrojnë që ti përfitojnë parat për çmimin e tyre blerës nëpërmjet prostitucimit.
- Dhjetëra mijëra gra çdo vitë janë objekt i dhunës seksuale në institucionet shëndetësore përfshirë edhe shqetësimin seksual nga ana e dhënsve të shërbimeve shëndetësore, sakatosjen e gjenitalieve, kontrolle gjinekologjike të detyruara dhe inspektime të domosdoshme për virgjinitet.
- Përdhunimi shfrytëzohet si armë luftarake dhe është e dokumentuar në shumë konflikte si ato në Alzhir, Bangladesh, Bosnjë e Hercegovinë, Indonezi, Liberi, Ruandë dhe Ugandë. Vetëm në Bosnjë e Hercegovinë llogaritet se numri i grave të përdhunuar sillet nga 10 000 deri 60 000.

Koeficienti i grave të cilat kanë paraqitur tentim ose përjetuar seks të dhunshëm nga partneri intim gjatë jetës, qytete të zgjedhura

Vendi	Viti	Madhësia e ekzemplarit	Tentim ose seks i dhunshëm i kryer (%)
Brazili (Sao Paolo)	2000	941	10,1
Kanadaja (Toronto)	1991-1992	420	15,3
Japonija (Jokohama)	2000	1 287	6,2
Meksiko (Gvadalajara)	1996	650	23,0
Nikaragua (Leon)	1993	360	21,7
Peruja (Kusko)	2000	1 534	46,7
Tajllandi (Bankog)	2000	1 051	29,9
Britania (Londëra veriore)	1993	430	23,0
Zimbabve (Provinca Midlands)	1996	966	25,0

PASOJAT E DHUNËS SEKSUALE

Dhuna seksuale mundet thellësisht të prek mirëqenien fizike, mentale dhe sociale të viktimave. Ajo lidhet me pasoja shëndetësore të numërta ku hyjnë:

- Shtatëzani e padëshiruar,
- Komplikime gjinekologjike si gjakderdhje vaginale, fibroide, dhimbje kronike në Karlicata dhe infektive në traktin urinar,
- Sëmundje seksualisht të bartshme përfshirë këtu edhe HIV/SIDA.
- depresion,
- çrregullime stresore post-traumatike,
- mendime dhe sjellje vetëvrasëse.

Viktimat mund të ballafaqohen edhe me njolllosjen nga ana e familjes, shokëve dhe bashkësive të tyre.

CILËT JANË FAKTORËT-RREZIK PËR DHUNË SEKSUALE?

Egzistojnë shumë faktor të cilët e rrisin rrezikun për dhunë seksuale. Këto faktor nuk ndikojnë vetëm në mundësin për përdhunim por edhe mbi reaktionin mbi te.

Faktor të cilët e zmadhojnë rrezikun për përdhunime tek burrat

- përdorimi i alkoolit dhe drogës,
- mungesa e inhibitorëve për shtypjen e asociacioneve ndërmjet seksit dhe agresionit,



Organizata botërore e shëndetësisë



Ministria e shëndetësis, RM




Enti Republikan për mbrojtje shëndetësore



Fondacioni Instituti i Hapur i Shoqëris Civile në Maqedoni



Shoqata për emancipim, solidaritet dhe barazi gjnore në RM



- të pasurit qëndrime dhe besime të cilat e përkrahin dhunën seksuale përfshirë edhe fantazit seksuale të dhunshme,
- model i sjelljes i cili është impulsiv, antisocial dhe armiqësor kundrejt grave,
- shoqërimi me moshatarë seksualisht agresiv,
- keqpërdorim seksual në fëmijëri,
- rritje në mjedis familjar e cila karakterizohet me dhunë fizike, përkrahje të vogël emocionale dhe pak resurse ekonomike.

Faktorë që kontribuojnë janë edhe varfëria, si dhe banimi në bashkësi me tolerim të përgjithshëm të dhunës seksuale dhe sanksione të dobëta kundër tij.

Është më e besueshme që të vihet deri tek dhuna seksuale aty ku besimi në të drejtat seksuale të meshkujve janë të forta, rolet gjinore—të ashpëra, si dhe në vende me shkallë të lartë të llojeve tjera të dhunës.

ÇKA MUND TË BËHET QË TË PARANDALOHET DHUNA SEKSUALE?

Përpjekjet për parandalimin e dhunës seksuale në masë të madhe fokusohen në::

- përkrahjen e viktimave,
- ndryshimin e ligjeve dhe politikave,
- shërbime shëndetësore dhe trajnim për dhënësit e tyre,
- programe edukative dhe fushata për ndryshimin e qëndrimeve dhe sjelljeve.

Pregaditen iniciativa për këshillime, terapi dhe grupe për përkrahje me qëllim që të zvoglohet trauma e dhunës seksuale dhe të përshpejtohet shërimi. Këto lloj shërbime tregohen si shumë të frytshme pas sulmit të mbijetuar.

Përgjigje juridike në politikë

Përpjekjet për reformim të përgjigjeve juridike përfshijnë:

- zgjerimin e definicionit për përdhunim, kështu që në të, të përfshihet edhe përdhunimi në martesë si dhe forma tjera të dhunës seksuale,
- reformimi i rregullave për dhënjën e dënimeve si dhe për pranimin e dëshmimeve,
- Largimi i kërkesës që dëshmitë e viktimës të jenë të mbështetura.

Në përgjithësi, përgjigjet juridike sillen kah nxitja e njerëzve që të paraqesin incidente të dhunës seksuale në polici dhe kah përmirësimi i shpejtësis dhe ndijshmëris në procesimin e lëndëve nga ana e gjyqeve. Ishin propozuar edhe reforma juridike dhe ekonomike për luftë kundër tregëtis me seks.

Shërbime shëndetsore dhe trajnime

Sektori shëndetsor ka një rol të veçantë në përgjigjen e saj për viktimat e dhunës seksuale, nëpërmjet:

- grumbullimit të dëshmimeve mjekësore dhe juridike,
- trajnim të dhënësve të shërbimeve shëndetësore,
- ofrimi i llojeve tjera të shërbimeve.

Dokumentacioni mjekësoro-juridik për sulmet seksuale mund në masë të madhe t'i rrisë gjasat për arrestim të kryerësit, akuzimin e tij si dhe dënimin.

Për fat të keq shërbimet mjekësoro-juridike në shumë vende nuk jepen në mënyrë rutine.

Prej një rëndësie të veçantë është edhe trajnimi i punëtorve shëndetësor. Trajnim i till duhet t'u jep atyre më shumë njohuri dhe vetëdije për dhunën seksuale dhe ti përmirësoj që në mënyrë më efektive ti zbulojnë dhe të mund të ballafaqohen me rastet e keqpërdorimit.

Programe edukative dhe fushata

Qasje tjera për luftë kundër dhunës seksuale koncentrohen në edukimin dhe ngritjen e vetëdijes ku hyjnë edhe programet edukative nëpër shkolla dhe mjediset e tjera të cilët i trajtojnë marrëdhëniet gjinore, detyrimet seksuale dhe shkathtësit për ndërtimin e marrëdhënieve të shëndosha.

Shfrytëzohen edhe fushata nëpër medime dhe aktivitetet e bashkësive nëpërmjet grupeve të burrave dhe grave që të ndryshohen modelet destruktive të sjelljes si dhe qëndrimet publike kah dhuna seksuale.